



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Repertori Statestikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM3-2016



Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitë publikimin “**Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet në Kosovë TM3 2016**”, i cili përmban të dhëna statistikore për bizneset e regjistruara tek Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) nga data 01.07.2016 deri me 30.09.2016 (tremujori i tretë 2016).

Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB) është pjesë e ASK-së i cili përmban informacionet themelore për të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin ekonomik në territorin e Republikës së Kosovës dhe si i tillë shërben për statistika dhe analiza të demografisë së bizneseve, përgatitjen e mostrave dhe ngritjen e rezultateve në nivel vendi për të gjitha anketat që realizohen me bizneset. RSB po ashtu shërben si burim i rëndësishëm i informacioneve për llogaritjen e Bruto Produktit Vendor.

RSB është ndërtuar dhe azhurnohet në vazhdimësi duke u bazuar në dy burime administrative të të dhënave (ARBK-së dhe Administrata Tatimore e Kosovës) si dhe hulumtimet e rregullta statistikore që kryhen nga ana e ASK-së.

Kërkesa të vazhdueshme për të dhëna statistikore për bizneset vijnë çdo ditë nga shfrytëzues të ndryshëm qoftë ata të brendshëm apo ata jashtë ASK-së, prandaj duke u bazuar në këto kërkesa kemi përgatitur të dhëna të ndryshme tabelore dhe grafike.

Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së, dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Komentet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato mund të dërgohen në adresën elektronike: muhamet.kastrati@rks-gov.net

Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet në Kosovë është publikim i rregullt tremujorë.

Publikimin e përgatitën:

Ilir T. Berisha - Drejtor i departamentit
Ismajl Sahiti – Shef i Divizionit
Hysni Elshani - Shef i sektorit,
Muhamet Kastrati - Specialist i TI-së për RSB,
Luljeta Krasniqi - Zyrtare e lartë,
Valdete Navakazi - Zyrtare e lartë,

Nëntor , 2016

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Lista e Shkurtesave

- ASK** Agjencia e Statistikave të Kosovës
- RSB** Regjistri Statistikor i Bizneseve
- ARBK** Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
- ATK** Administrata Tatimore e Kosovës
- MTI** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- BPV** Bruto Produkti Vendor (GDP)
- AKP** Agjencioni Kosovar i Privatizimit
- KE** Komisioni Evropian
- NVE** Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike
- NACE Rev. 1** (Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike të KE - Versioni 1-rë)
- NACE Rev. 2** (Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike të KE - Versioni 2-të)
- NVM** Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
- TM1** Tremujori i parë
- TM2** Tremujori i dytë
- TM4** Tremujori i tretë
- TM4** Tremujori i katërt

Simbolet

- Nuk ka dukuri
- : Mungojnë të dhënat

Përmbajtja

	Faqe
1 Karakteristikat e ndërmarrjeve të reja në TM3 2016.....	4
2 Shpjegimet metodologjike dhe përkufizime	5
2.1. Përkufizime dhe definicione	6
2.2. Forma ligjore (legale) e organizimit të bizneseve	7
3 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe te shuara TM1 2012- TM3 2016.....	8

1 Karakteristikat e ndërmarrjeve të reja në TM3 2016

Gjate tremujorit të tretë të vitit 2016 (TM3 2016) kemi 2476 ndërmarrje të reja të regjistruara. Ndersa te shuara gjate kësaj periudhe ishin 457 ndërmarrje.

Rritje për 8.4% të ndërmarrjeve të regjistruara kemi nëse e krahasojmë me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM3 2015).

Rënie për 11.6% e ndërmarrjeve të regjistruara vërehet krahasuar me tremujorin paraprak (TM2 2016).

Aktiviteti ekonomik më i preferuar gjatë këtij tremujori ishte tregtia me 21.7% të ndërmarrjeve të regjistruara.

Kategoria e numrit të punësuarve nga 1-9 (të punësuar) (mikro) përbën 96.6% të ndërmarrjeve të reja.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave ashtu si në çdo tremujorë mbizotëron Prishtina me 24.9%.

2 Shpjegimet metodologjike dhe përkufizime

Regjistri Statistikor i Bizneseve shërben për qëllime statistikore dhe duhet të identifikojë qartësisht njësitë, në mënyrë që:

- Të mundësojë marrjen e informacionit për to nëpërmjet burimeve administrative.
- Të mundësojë përgatitjen e mostrave; koordinimin e anketave dhe ngritjen e rezultateve të tyre në nivel vendi;
- Të mundësojë analizën demografike të ndërmarrjeve dhe njësive lidhur me to.
- Të ofroj të dhënat hyrëse (imput) për llogaritjen e Bruto Produktit Vendor (GDP).

Regjistri Statistikor i Bizneseve (RSB)- **Përmban** të gjitha njësitë legale (bizneset apo ndërmarrjet) që ushtrojnë aktivitetin ekonomik brenda territorit të Kosovës.

Nuk përmban: Administratën Publike, Organizatat Jo Fitimprurëse, Organizatat Ndërkombëtare.

Burimet për azhurnimin e variablave të RSB-së janë:

- Administrative
 - Informacionet nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
 - Informacionet nga Administrata Tatimore e Kosovës
- Statistikore
 - Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
 - Anketat për Statistikat Afatshkurtra
 - Anketa mbi Hotelerinë
 - Mbledhja e Çmimeve të Prodhimit
 - Mbledhja e Çmimeve të Importit.

Variablat kryesore të RSB grupohen në:

- **Variablat e Identifikimit**
 - Numrin e Regjistrimit të Biznesit (NRB), emri, forma legale, pronësia, adresat, komunikimi (tel, faks, e-mail etj)
- **Variablat shtresore**
 - Aktiviteti ekonomik kryesor (NACE Rev.2), madhësia sipas numrit të punësuarve
- **Variablat demografike**
 - Data e regjistrimit, data e shuarjes
- **Variablat që azhurnohen janë**
 - Statusi i aktivitetit (aktive ose jo-aktive),
 - Aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes,
 - Madhësia sipas të punësuarve,
 - Adresat dhe variabla të komunikimit (telefon, faks, mobil, e-mail)

2.1. Përkufizime dhe definicione

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), është klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara në subjekte të ndryshme.

Kjo nomenklaturë është përkthim dhe përshtatje e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Komunitetit Evropian (NACE Rev.2. në Gjuhën Angleze).

Përdorimi i kësaj nomenklature është obligative që nga data 1 shtator 2014 në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe bazohet në rregulloren Nr.11/2013 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Struktura e veprimtarive ekonomike NACE Rev. 2 përbëhet nga 21 seksione të cilat janë prezantuar me poshtë të emërtuar me shkronja nga A deri tek U.

- A. Bujqësi, pylltari dhe peshkatari
- B. Xehetari dhe gurëthyes
- C. Prodhim
- D. Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar
- E. Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës
- F. Ndërtimtari
- G. Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave
- H. Transport dhe ruajtje
- I. Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim
- J. Informacion dhe komunikim
- K. Aktivitete financiare dhe sigurimit
- L. Aktivitete të patundshmërisë
- M. Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
- N. Aktivitete administrative dhe mbështetëse
- O. Administratë publike dhe mbrojtje
- P. Arsim
- Q. Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale
- R. Art, zbavitje dhe rekreacion
- S. Aktivitete të shërbimeve tjera
- T. Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës
- U. Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale

Klasat e veprimtarive ekonomike sipas nomenklaturës së re **NACE Rev. 2** janë gjithsej 615 sosh, të cilat janë të koduar me kodin katërshifror duke filluar nga 0111 deri tek 9900.

2.2. Forma ligjore (legale) e organizimit të bizneseve

Definicionet e aplikuara për format ligjore të ndërmarrjeve sipas Rregullores 2001/16 si dhe Ligji nr.02/L123 mbi Shoqëritë tregtare dhe aksionare, e që aplikohen me rastin e regjistrimit në ARBK janë si në vijim.

1. Biznes individual - është person i vetëm fizik i cili kryen aktivitete ekonomike për qëllim të profitit dhe i cili është i regjistruar në ARBK-ë. Në biznesin individual, pronari ka përgjegjësi të pakufizuar për të gjitha borxhet e shoqërisë. Shoqëria ka një emërtim zyrtar ose përfshin mbiemrin e ligjshëm të pronarit.

2. Ortakëri e përgjithshme - Te ortakëria e përgjithshme, të gjithë ortakët përgjigjen pa kufizim, e solidarisht për borxhet e shoqërisë. Shoqëria kolektive ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve.

3.Ortakëri e kufizuar - (Shoqëri komandite) - Në shoqëritë komandite, përveç ortakëve "të pakufizuar" (ortakët që përgjigjen pa kufizim e solidarisht për borxhet e kompanisë) marrin pjesë edhe ortakët "e kufizuar" ose ata ortakë, që përgjigjen për detyrimet e kompanisë deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

4.Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar - Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara janë ato shoqëri që janë themeluar nga një ose disa themelues, të cilët përgjigjen vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara ka një emërtim, në të cilin mund të përfshihet emri i një ose më shumë ortakëve.

5.Shoqëri aksionare - Shoqëri aksionare janë ato shoqëri, kapitali i të cilave ndahet në aksione dhe që aksionaret përgjigjen vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre. Shoqëria mund të themelohet e të ketë një ose disa aksionar.

6.Kompani e huaj - Kompania e huaj është shoqëri tregtare dhe prej momentit të regjistrimit konsiderohet si dega në Kosovë që nuk ka identitet të personit juridik. Pas regjistrimit i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e themeluara në bazë të ligjit të zbatueshëm.

7.Ndërmarrje shoqërore - Ndërmarrje shoqërore do të thotë një person juridik që shumica e asetëve dhe kapitali janë në pronësi shoqërore . Këto ndërmarrje deri në privatizim monitorohen dhe regjistrohen nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit sipas Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

8.Ndërmarrjepublike - Ndërmarrja Publike është ndërmarrje e cila kryen veprimtarinë e interesit të përgjithshëm, që është e themeluar nga shteti. Ndërmarrja publike monitorohet nga Qeveria dhe organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare. Të gjitha interesat pronësore në një ndërmarrje publike do të përfaqësohen me aksione dhe të gjitha këto aksione duhet të jenë të regjistruara.

9.Kooperativa bujqësore - Kooperativa bujqësore është një shoqëri tregtare e krijuar nga personat fizikë apo juridik të cilët duhet të jenë të gjithë bujq që kontribuojnë me pronën e vet private në kapitalin aksionar.

10.Ndërmarrje nën juridiksion të AKP - Janë ish ndërmarrjet shoqërore të cilat tani menaxhohen dhe mbikëqyren nga AKP-ja (Agjencioni Kosovar i Privatizimit).

3 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe te shuara TM1 2012-TM3 2016

Tabela 1. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas tremujorëve dhe seksioneve të aktiviteteve ekonomike.

Periudhat	Tremujoret	Gjithsej	Seksionet e aktiviteteve ekonomike																		
			A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
			Bujqësi, pylltari dhe peshkari	Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	Ndërtimtari	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitete financiare dhe sigurimit	Aktivitete të patundshmerisë	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social I detryrueshëm	Arsim	Shëndetësi njerëzor dhe aktivitete të punës sociale	Art, zbavitje dhe rekreacion	Aktivitete të shërbimeve tjera
2012 - TM1		2528	174	9	239	5	18	268	820	175	243	96	4	9	155	57	7	32	39	48	130
2012 - TM2		2736	218	26	278	3	17	259	809	156	300	82	3	10	190	70	6	24	36	36	213
2012 - TM3		2051	127	9	184	7	12	193	598	140	205	84	6	11	131	48	8	32	34	56	166
2012 - TM4		2261	222	11	201	5	12	224	691	139	207	78	3	7	137	78	4	26	20	54	142
2012 Gjithsej		9576	741	55	902	20	59	944	2918	610	955	340	16	37	613	253	25	114	129	194	651
2013 - TM1		3100	301	10	299	9	19	337	867	201	264	104	6	135	169	60	9	32	48	54	176
2013 - TM2		2504	142	7	258	2	14	227	759	107	246	101	4	95	162	65	9	28	43	52	183
2013 - TM3		2011	122	7	163	6	11	201	565	108	240	82	8	15	119	53	6	20	48	63	174
2013 - TM4		1805	188	5	152	5	6	178	543	109	161	70	2	12	135	36	9	18	34	62	80
2013 Gjithsej		9420	753	29	872	22	50	943	2734	525	911	357	20	257	585	214	33	98	173	231	613
2014 - TM1		2911	205	10	283	4	13	284	887	181	293	121	12	21	180	77	12	33	50	88	157
2014 - TM2		2399	186	9	283	3	16	207	704	99	282	95	8	10	146	61	11	20	39	55	165
2014 - TM3		1919	115	7	196	3	13	146	574	111	237	61	11	7	97	49	2	18	33	60	179
2014 - TM4		2175	168	6	216	14	9	166	649	143	222	80	12	21	147	65	17	19	51	50	120
2014 Gjithsej		9404	674	32	978	24	51	803	2814	534	1034	357	43	59	570	252	42	90	173	253	621
2015 - TM1		2582	255	7	276	8	12	237	784	143	253	104	12	15	144	80	6	20	36	57	133
2015 - TM2		2487	212	12	261	5	13	193	751	142	263	98	15	15	139	76	10	29	67	60	126
2015 - TM3		2284	208	8	239	4	8	160	622	108	256	86	43	19	123	66	3	25	49	68	189
2015 - TM4		2480	270	5	271	13	15	163	746	131	246	80	25	25	175	74	6	35	35	58	107
2015 Gjithsej		9833	945	32	1047	30	48	753	2903	524	1018	368	95	74	581	296	25	109	187	243	555
2016 - TM1		2896	261	16	343	12	17	254	820	151	249	108	68	14	183	82	8	40	63	73	134
2016 - TM2		2801	223	6	334	11	13	202	779	150	326	114	34	17	170	101	6	42	60	51	162
2016 - TM3		2476	372	6	258	9	26	194	552	125	232	105	28	15	122	81	8	31	46	77	189

Tabela 2. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas tremujoreve, TM1 2012 deri TM3 2016

Tremujori	Ndërmarrje të reja	Ndërmarrje të shuara
2012-TM1	2543	218
2012-TM2	2736	265
2012-TM3	2052	264
2012-TM4	2261	334
2013-TM1	3101	407
2013-TM2	2504	355
2013-TM3	2011	342
2013-TM4	1805	404
2014-TM1	2912	436
2014-TM2	2399	445
2014-TM3	1919	343
2014-TM4	2175	447
2015-TM1	2582	501
2015-TM2	2487	435
2015-TM3	2284	299
2015-TM4	2480	970
2016-TM1	2896	727
2016-TM2	2801	657
2016-TM3	2476	457


Figura 1. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara në TM3 sipas viteve


Tabela 3. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara në TM3 2016

Sektoret	Kategoria e numrit të punësuarve					
	Gjithsej	1-4	5-9	10-19	20-249	250+
BUJQËSI	372	364	8	-	-	-
INDUSTRI	299	287	8	1	3	-
NDËRTIMTARI	194	189	4	1	-	-
TREGTI	552	538	13	-	1	-
SHËRBIME	1059	1023	27	8	1	-
Gjithsej	2476	2401	60	10	5	-

Burimi i të dhënave: Regjistri Statistikor i Bizneseve





Figura 1. Shpërndarja e regjistrimeve sipas sektorëve

Figura 2. Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese;* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. *Departamentet mbështetëse;* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 139 punëtorë, prej tyre, 104 (74,8%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 35 (25,2%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 70,5% me shkollim universitar ndërsa 29,5% me shkollim te mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe banesave ,i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>